



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. 4672/prot.  
13

Pogradec, më 15.11.2023

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**ZNJ. MANJOLA KAMOLLI, KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, për: “Miratimi i Hartës së Përgjithshme për Plazhet e lejuara në Bashkinë Pogradec për vitin 2024”

Me respekt,

**KRYETARI**

**Ilir XHAKOLLI**



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: \_\_\_\_\_

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: \_\_\_\_\_

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

**RELACION**

Në lidhje me Projekt-Vendimin “Miratimi i Hartës së Përgjithshme për plazhet e lejuara në Bashkinë Pogradec për vitin 2024”

**E nderuar Kryetare e Këshillit!**  
**Të nderuar Këshilltarë !**

Në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i ndryshuar, Bashkia Pogradec, hartoi hartën e përgjithshme për Plazhet e lejuara për vitin 2024.

Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik bëhet proporcionalisht, sipas raportit 70% / 30% dhe në mënyrë perpendikulare me vijën bregdetare.

**Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.**

**Faleminderit!**

**Të dhënat e projekt vendimit:**

Konceptoi: Marjano Tasellari

Miratoi: Anxhela Piliñçi

Konfirmoi: Paskalino Ziko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

PROJEKT - VENDIM  
NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023  
PËR

“MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME PËR PLAZHET E LEJUARA NË  
BASHKINË POGRADEC PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja "b" dhe pika 1/1/2 shkronja "a", neni 23 pika 14, neni 54, shkronja "k", nenit 55, të ligjit nr.55, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Ligjit Nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar, Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, Ligjit Nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 321, datë 28.05.2014, "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", i ndryshuar, ligjit 9251, datë 08.07.2014 "Kodi detar i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 2 pika "c" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019, "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë;

KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:



1. Miratimin e "Hartës së përgjithshme për plazhet e lejuara në Bashkinë Pogradec për vitin 2024", (bashkëlidhur) e cila përmban:

- a) hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari si stacion plazhi;
- b) hapësirat e plazhit publik;
- c) vendndodhjen e kullave dhe pikave të vrojtimit;
- ç) zonën e çadrave;
- d) zonën e shërbimeve;
- dh) hapësirën ujore të lejuar për notim (zonë e rrethuar me bova);
- e) vendbazimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre;

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Turizmit dhe Rinisë pranë Bashkisë Pogradec.

3. Shfuqizimin e të gjitha vendimeve të mëparshme të Këshillit Bashkiak, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**KRYETARE**  
**Manjola KAMOLLI**